



DIPARTIMENTO DI SCIENZE DELL'EDUCAZIONE
"GIOVANNI MARIA BERTIN"



Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology



Save the Children

KNF-FR PËR PROMOVIMIN E PROCESIVE GJITHËPËRFSHIRËSE NË PLANET ARSIMORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KNF-FR¹ PËR PROMOVIMIN E PROCESEVE GJITHËPËRFSHIRËSE NË PLANET ARSIMORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS²

Roberto Dainese, Profesor i Asocuar i Didaktikës dhe Pedagogjisë Speciale,
Departamenti i Shkencave të Arsimit, Universiteti i Bolonjës, roberto.dainese@unibo.it.

Elisabetta Ghedin, Hulumtuese e Didaktikës dhe Pedagogjisë Speciale, Departamenti
FISPPA, Universiteti i Studimeve të Padovës, elisabetta.ghedin@unipd.it

¹ Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit - versioni për fëmijë dhe të rinj (OBSh, 2007)

² Tema e trajtuar është ndarë mes dy autorëve; specifikohet se Roberto Dainese ka përpiluar hyrjen, seskionet 1, 4.1 dhe përfundimet; ndërsa Elisabetta Ghedin, seksionet 2, 3, dhe 4. Shtojca është shkruar nga të dy autorët.

KNF-FR për promovimin e proceseve gjithëpërfshirëse në planet arsimore të Republikës së Kosovës

Roberto Dainese dhe Elisabetta Ghedin

Titulli i origjinalit: L'ICF-CY per la promozione dei processi inclusivi nei contesti educativi nella Repubblica del Kosovo

Publikuar nga Save the Children International në Kosovë

Gazmend Zajmi 1, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 232 691

Email: scik@savethechildren.org

Të drejtat e publikimit © Save the Children International në Kosovë, 2019
Lejohet fotokopjimi i ekstrakteve të këtij dokumenti për përdorim me qëllim për të promovuar zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës. Të gjitha të drejtat e tjera të rezervuara.

Të drejtat autoriale © Dainese, R. & Ghedin, E., 2019

Përkthyer nga italishtja në shqip nga Arjeta Berisha

Dizajni i ballinës dhe radhitja kompjuterike nga Gojart Sejdiu, Pi Communication
Printuar dhe lidhur nga Pi Communication

ISBN 978-9951-534-56-7

Ky projekt është mbështetur nga Save the Children në Kosovë.

Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materiali e mbajnë plotësisht autorët dhe Save the Children nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim.

Përmbajta

Hyrje.....	5
Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë.....	6
Promovimi i qasjes në arsim përmes KNF-FR-së	10
Metoda	13
Pyetjet hulumtuese.....	13
Trajnimi	15
Puna hulumtuese.....	17
Përfundime	22
Referencat bibliografike.....	23
Shtojca: Instrumentet.....	25

Hyrje

Rruga e hulumtim-trajnitimit e prezantuar në këtë dokument ka të bëjë me ndërtimin e një dosjeje dokumentesh të bazuara mbi modelin e funksionimit bio-psiko-social të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit – versioni për Fëmijë dhe të Rinj (KNF-FR) (Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), 2007), që u referohet si komisioneve që merren me hartimin e profileve të rritjes dhe të zhvillimit të fëmijëve që gjejnë vështirësi të ndryshme në shkollë (të quajtura Ekipe Vlerësuese Komunale), po ashtu edhe shkollave të Kosovës.

Veprimet e ndërmarra deri më sot na kanë lejuar të shkojmë përtej ndërtimit të dosjes, duke zhvilluar në këtë mënyrë, reflektime dhe praktika të përshtatshme për të mbështetur promovimin e një trajnimi pjesëmarrës që synon gërshetimin e kulturave, praktikave dhe politikave gjithëpërfshirëse, në harmoni me kërkesat që vijnë nga *Indeksi për Gjithëpërfshirje*, zhvilluar në Mbretërinë e Bashkuar nga Booth dhe Ainscow (2008, 2014).

Për të kuptuar më mirë supozimet që kanë mbështetur rrugën e këtij hulumtim-trajnitimi, është thelbësore që në vazhdim të propozohet një reflektim i përmbledhur mbi edukimin gjithëpërfshirës në Kosovë, në mënyrë që më pas të përshtatet me mundësitë që modeli KNF-FR është në gjendje të ofrojë për promovimin e tij.

1

Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë

Rindërtimi i historisë së kohëve fundit të Kosovës, na lejon të kuptojmë në mënyrë adekuate përpjekjen e bërë për të arritur të një stabilitet i brendshëm.

Përkundër kësaj situatë të pasigurisë së dukshme dhe për të kundërshtuar zgjidhjet përçarëse, duket se është ushqyer dëshira për të përkrahur ato shtesa përparimtare që janë në gjendje për të krijuar një shtet vendosmërisht të gatshëm për të mbrojtur të drejtat e njerëzve që jetojnë aty, duke përfshirë në mënyrë të domosdoshme shkollën që, jo vetëm që duhet të jetë në gjendje të aftësojë qytetarët me ideale gjithëpërfshirëse, por që do të duhej t'i garantonte gjithsecilit të drejtën për të mësuar në shkollë, pra çdo nxënës, përfshirë edhe ata më të pambrojturit.

Vitin e fundit janë shënuar disa hapa drejt sistematizimit të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Megjithatë, shkalla e përfshirjes së tyre ende mbetet në 40%³. Në Kosovë numërohen pak më shumë se 356,200 nxënës në arsimin para-universitar⁴, prej të cilëve, 4,766 janë identifikuar zyrtarisht me nevoja të veçanta arsimore, 4,451 vijojnë shkollat e rregullta dhe klasa të bashkëngjitura, dhe 315 në qendra burimore (të njohura më pare si “shkolla special”)⁵.

Kosova, e vetëdijshme për urgjencat e theksuara nga të dhënat e mësipërme, prej disa vitesh e ka parë të nevojshme që të ndër marrë aktivitete trajnimi dhe studimi që synojnë promovimin e gjithëpërfshirjes, para së gjithash, të nxënësve me aftësi të kufizuara. Kjo është një kërkesë që ka nisur nga universiteti, nga shkolla dhe që ka prekur edhe qeveri të ndryshme, duke bërë kështu të mundur edhe lindjen e një interesi real nga ana e Ministrisë së Arsimit për të marrë pjesë në mënyrë aktive në këtë fazë të ndryshimit.

3 Raporti Vjetor i Vlerësimit 2018: i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021 (MASHT, 2019)

4 Ibid

5 Raporti vjetor statistikor me tregues arsimor, për vitin shkollor 2017-18 (MASHT, 2018)

Në të vërtetë, arsimi është vendosur ndër prioritetet e veprimtarisë së ringjalljes së vendit; thotë Tim Goddard, Profesor në Universitetin e Prince Edward Island dhe studiues që është marrë me rindërtimin e pasluftës në Kosovë:

Ndërhyrjet arsimore në Kosovën e pas konfliktit u zhvilluan në nivelet makro (politikë), meso (institucional) dhe mikro (individual). Aktivitetet e Projekti i Zhvillimit të Mësimdhënësve në Kosovë (anglisht: Kosovo Educator Development Project) ndikuan në të tre nivelet e mësipërme. U themelua një Bord për Shqyrtimin dhe Trajnimin e Mësimdhënësve për të rishikuar dhe krijuar politika në lidhje me trajnimin, besueshmërinë dhe përgjegjshmërinë profesionale të mësimdhënësve. Në Universitetin e Prishtinës u themelua Fakulteti i Edukimit dhe një program i zhvillimit për administratorët e lartë u inicia në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në fund, u konceptua, u dizajnuar dhe u zbatua një program mësimor, me në qendër nxënësin, për mësimdhënësit dhe një program i zhvillimit të lidërsipit për administratorët e shkollave. (Goddard, 2008, f.76)

Objektivat e dy programeve, Projekti i Zhvillimit të Mësimdhënësve në Kosovë) dhe Bordi Shqyrtues i Trajnimit të Mësimdhënësve synonin, nga njëra anë zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të reja dhe nga ana tjetër, të bënin të mundur që këto të fundit të mund të ndikonin në një ndryshim në kontekstin politik (makro) dhe legjislativ (meso).

Sot, Kosova ka përforcuar zotimet e saj për gjithëpërfshirjen në arsim, duke zhvilluar standarde të përshtatura për fëmijë, duke forcuar legjislacionin për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe veçanërisht të atyre me aftësi të kufizuara.

Ngjarjet historike, në mënyrë të pashmangshme, e kanë lënë Kosovën pas të gjithë treguesve të zhvillimit ekonomik dhe arsimor në Evropë, por burimet për rindërtimin dhe rigjenerimin e sistemit shkollor vazhdojnë të vijnë edhe sot nga shumë agjenci donatore ndërkombëtare, të cilat kanë bërë të mundur arritjen e objektivave domethënëse: rindërtimi i shkollave, zhvillimi i politikave arsimore dhe programeve të reja të studimit. Për më tepër, është ndërmarrë edhe një veprim themelor i decentralizimit të përgjegjësive në lidhje me politikën arsimore, duke u dhënë hapësirë autoriteteve arsimore lokale/komunale dhe jo vetëm shërbimeve qendrore të Ministrisë.

Departamenti i Shkencave të Arsimit të Universitetit të Bolonjës prej shumë vitesh, së bashku me Save the Children Italinë, ka ndërmarrë një akt bashkëpunimi në Kosovë që ka çuar drejt - në fazën e parë – realizimit të një draft-programi të një Masteri në “Arsim gjithëpërfshirës”. Në vitet në vijim, me mbështetjen e një Projekti TEMPUS të financuar nga Bashkimi Evropian⁶, vazhdoi puna mbi draft programin e Masterit dhe u arrit ndërtimi përfundimtar i kursit të ri të studimit i cili më pas iu nënshtrua vlerësimit të Ministrisë. Programi i Masterit u miratua dhe vitin e kaluar studentët e parë përfunduan kursin e parë të studimit në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë.

Me shumë gjasë, për të përcaktuar një ndryshim të mëtejshëm domethënës për kushtet arsimore dhe formuese të fëmijëve me aftësi të kufizuara, është e nevojshme të hidhet hipoteza për një përpjekje të vazhdueshme, e gatshme për të siguruar ndryshime të shpejta dhe masive që, në fushën arsimore, për shembull, të mund të respektohen parimet e përfshira në dokumentet ndërkombëtare që sot për sot konsiderohen si referenca të domosdoshme nga shumë shtete.

Referenca është, veçanërisht, në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006) dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e fëmijës (1989); në fakt, me këto dokumente qeveritë në mbarë botën kanë marrë përsipër përgjegjësinë për t’u garantuar të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga shkalla e tyre e aftësisë apo e mosaftësisë, të drejta të barabarta, pa diskriminim të asnjë lloji. (UNICEF, 2013, f. 3).

Nga kjo rrjedh fakti se një nga sfidat më të rëndësishme për mësimdhënësit dhe profesionistët e ndryshëm të përfshirë në fushën arsimore është përcaktimi i parimeve themelore dhe të përshtatshme të arsimit gjithëpërfshirës. Dhe, për këtë arsye, është thelbësore të merren si vendimtarë treguesit e mëposhtëm pedagogjikë, të cilët konsiderohen si përcaktues dhe me ndikim të vazhdueshëm:

- të kuptuarit e çdo gjendjeje njerëzore, edhe e asaj që është më e rrezikuar, për sa i përket funksionalitetit të saj, në mënyrë që gjithmonë të paraqitet një projekt i lartësimit të personit;
- të hedhurit e hipotezave për ndërhyrjet jo vetëm në aspektet e mirëqenies, por në aspektet ekzistenciale, duke u dhënë shtysë vetë ndërhyrjeve në rrugën e jetës së personit me aftësi të kufizuara;

⁶ Projekti Tempus në Kosovë Med@up “Modernizing Teacher Education at University of Prishtina” (Numri i projektit 544023) koordinuar nga Roberta Caldin, në të cilin morën pjesë docentët dhe hulumtuesit në vazhdim: Andrea Ciani, Elena Pacetti, Federica Zanetti, Roberto Dainese, Valeria Friso – Universiteti i Bolonjës.

- të kuptuarit e aftësive të kufizuara në trajektore të gjera dhe shumëdimensionale (ato të etikës, moralit, ligjshmërisë, të të drejtave);
- të vepruarit kryesisht në planin e jetës dhe të të mësuarit, për të inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithëve;
- të promovuarit e një marrëdhënieje bashkëpunimi dhe shkëmbimi konstruktiv me familjet dhe profesionistët e tjerë;
- të vepruarit duke gërshetuar rrjete marrëdhëniesh domethënëse në territor (Dainese, 2017).

Çështja e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara mbetet një nga sfidat kryesore të ndërmarra nga Kosova dhe kërkon mobilizimin e të gjithë përbërësve institucionalë të përfshirë në sigurimin që fëmijët t'i gëzojnë të drejtat e tyre dhe që të ofrohen mundësi të barabarta për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë. Në këtë drejtim, korniza konceptuale e KNF-FR (OBSH, 2007) si paradigmë dhe taksonomi e funksionimit njerëzor, mund të përdoret për të udhëhequr qasjet arsimore gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore.

2

Promovimi i qasjes në arsim përmes KNF-FR-së

Zhvillimi i çdo shteti shkon paralel me përgjegjësinë e tij për të promovuar rritjen e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të shëndetshëm dhe të arsimuar. Këto përgjegjësi, përgjithësisht janë detyrë e Agjencisë Kombëtare të Shëndetit dhe të Edukimit Publik me mandate të ndara, për të promovuar shëndetin dhe qytetarinë e informuar dhe për të parandaluar përkatësisht sëmundjet dhe analfabetizmin. Edhe pse natyra dhe niveli i zbatimit të këtyre përgjegjësive ndryshojnë në bazë të përparësive të identifikuara nga vendet në mbarë botën, premisa për promovimin e shëndetit dhe edukimin e qytetarëve bazohet në përmbushjen e të drejtave universale të njeriut.

Këto të drejta korrespondojnë me të drejtat universale, përfaqësuese për të gjithë fëmijët në nivelin më të lartë të arritshmërisë shëndetësore (neni 24) dhe të arsimimit (neni 28), siç përcaktohet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNICEF, 1989). Respektimi i të drejtave universale të fëmijëve bazohet në një kornizë dhe në një gjuhë të përbashkët për përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve. Edhe pse Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (anglisht: International Standard Classification of Education - ISCED) siguron një sistem zyrtar për të përshkruar strukturën e arsimit publik, megjithatë ai nuk është në gjendje të ofrojë një sistem të plotë për dokumentimin e praktikave arsimore dhe didaktike dhe të karakteristikave mjedisore në fushën e arsimit, në një mënyrë paralele me informacionet etiologjike dhe demografike të disponueshme në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve (anglisht: International Classification of Diseases - ICD-10) në lidhje me shëndetin publik. Përveç ISCED-së, nuk ekziston një klasifikim i vetëm në fushën e arsimit që të përshkruajë në mënyrë sistematike mjedisin fizik dhe didaktik, dimensionet e mësimdhënies dhe mësiminxënies, karakteristikat e mësimdhënësve, të studentëve, vlerën e marrëdhënies të tyre, ose qëllimet arsimore dhe arritjen e tyre.

Shkurtimisht, mund të themi se deri më sot arsimit nuk ka krijuar një gjuhë të përbashkët për të përshkruar karakteristikat e popullatës dhe të mjedisit, si dhe për të vlerësuar shkallën në të cilën shkollat po i marrin përsipër përgjegjësitë e tyre në përballimin e të drejtave universale të fëmijëve. Sidoqoftë, mungesa historike e një

klasifikimi në fushën arsimore mund të përligjet, të paktën pjesërisht, me prezantimin e KNF, të botuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH, 2002).

KNF-ja është një taksonomi universale e funksionimit të njeriut në lidhje me faktorët kontekstualë që klasifikohen në terma të fushave të shëndetit dhe të fushave të lidhura me shëndetin. Shembuj të fushave të shëndetit përfshijnë të shikuarit, të dëgjuarit, të ecurit, të nxënësve dhe të kujtuarit, ndërsa shembuj të fushave të lidhura me shëndetin përfshijnë transportin, arsimin dhe ndërveprimet shoqërore (OBSH, 2002, f. 7).

Si klasifikim ndërdisiplinor, KNF-ja adaptohet gjithnjë e më shumë nga shërbimet dhe disiplinat për zhvillimin e një sërë masash për të vlerësuar funksionimin, aftësisë e kufizuar, mjediset dhe rezultatet e ndërhyrjes (Mpofu, Oakland, 2010). KNF-ja ka fuqinë për të lidhur mes tyre agjenci të ndryshme, grupe profesionale dhe përgjegjës politikë, profesionistë, prindër, fëmijë dhe të rinj dhe kjo vlerë është thelbësore për përdorimin e saj të vazhdueshëm. Si e tillë, KNF-ja vë përballë fusha të rëndësishme për arsimin dhe ofron një burim kohor për dokumentimin sistematik të popullatave në kontekstet arsimore. KNF-FR-ja ofron një gjuhë të përbashkët që mund të përdoret për të përshkruar karakteristikat e shkollave dhe praktikave të tyre dhe funksionimin e nxënësve në mjedisin arsimor.

Struktura shumëfunktionale dhe taksonomia e KNF-FR-së janë të zbatueshme për një sërë aktivitetesh që mbështesin arsimimin dhe kujdesin e fëmijëve. Në fushën shkencore, janë zhvilluar një seri aplikimesh të KNF-FR-së që kanë të bëjnë me politikat, praktikat dhe hulumtimin në arsim dhe me kujdesin për fëmijët (Moretti, Alves, Maxwell, 2012; Bjorck-Akesson *et al*, 2010). Në mënyrë të veçantë, KNF-FR-ja mund ta informojë politikën arsimore duke ofruar: (a) një kornizë gjithëpërfshirëse, (b) një gjuhë të përbashkët dhe (c) një referencë standarde për të drejtat e nxënësve. Në lidhje me praktikën arsimore, gjuha e përbashkët e KNF-FR-së mund të shërbejë për të dokumentuar (d) funksionimin dhe angazhimin e nxënësve, (e) natyrën e mjedisit të tyre shkollor dhe (f) rezultatet e arsimimit të tyre.

Qëllimi i saj kryesor është të sigurojë një klasifikim të funksionimit, duke marrë parasysh jetën e përditshme, të gjitha aktivitetet që zhvillohen dhe mjediset në të cilat jetojnë njerëzit, duke shkuar përtej kushteve shëndetësore dhe duke zgjeruar vizionin e qasjes tradicionale ndaj aftësisë së kufizuar, prezente në shumë vende, të cilën e sheh si një problem që banon tek individit, i shkaktuar drejtpërdrejt nga sëmundja, nga një dëmtim, nga ndonjë gjendje tjetër shëndetësore dhe kërkon trajtim mjekësor në formën e terapisë, trajtimit ose rehabilitimit (Ghedin, 2009).

KNF-ja sugjeron që këto vështirësi nuk mund të shpjegohen vetëm në termat e dëmtimit të fëmijëve. Këto janë karakteristikat e vetë sistemit arsimor - kurríkula të hartuara dobët, mësimdhënës të trajnuar dobët, praktika të papërshtatshme mësimore, ndërtesa të paqasshme - të cilat mund të krijojnë pengesa në nxënie. Në këtë rast, veprimi i nevojshëm është të kuptosh se cilat janë pengesat në të nxënë (në mënyrë që ato të zvogëlohen ose eliminojnë) dhe cilat burime duhet të zhvillohen për t'iu përgjigjur nevojave/aspiratave të të nxënës të këtyre fëmijëve (UNESCO, 2005).

Në të vërtetë, shikimi i promovimit të gjithëpërfshirjes përmes lenteve të KNF-së nënkupton një ndryshim nga fokusimi mbi fëmijën, tek një shqetësim në trajtimin e sistemit arsimor si problem. Qasjet e mëparshme (siç është, për shembull, modeli bio-mjekësor i aftësisë së kufizuar) nënvizonin se shkaku i vështirësive në të nxënë vinte nga brendia e atij që mëson (shpesh duke e identifikuar atë me vetë dëmtimin, në deficit, në sindromë) dhe injoronin ndikimet mjedisore në të nxënë. Nga ana tjetër, perspektiva e KNF-së lejon një analizë të situatës ku të nxënës nuk zhvillohet në mënyrën e paraparë ose të dëshiruar dhe, për këtë arsye, ndihmon në identifikimin dhe planifikimin e ndërhyrjeve të duhura arsimore me qëllim të ofrimit të mundësive për aktivitete dhe lehtësime për pjesëmarrje, në një kontekst të ndërtuar siç duhet. (Santi, 2004).

KNF-ja organizon funksionimin njerëzor në një klasifikim shumëdimensional, duke adaptuar një qasje situative, e cila i përgjigjet pyetjes: cila është situata aktuale e jetës së një fëmije? Struktura dhe modeli i KNF-së mund të përdoren për të sqaruar idetë implicite të atyre që janë të përfshirë në procesin arsimor. Idetë implicite të mësimdhënësve mbi aftësinë e kufizuar për shembull, të kuptuarit e tyre për dinamikën e aftësisë së kufizuar dhe pritshmëritë e tyre ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara mund të përbëjnë një pengesë në gjithëpërfshirjen dhe inkurajimin e praktikave sipas të cilave manifestohet përjashtimi nga mjediset arsimore. Marrja parasysh e të gjitha fushave të jetës së KNF-së dhe parashikimi i ndikimit të përgjithshëm të ndërhyrjeve të planifikuara, mund të ndihmojë në shmangien e krijimit të pengesave të reja në fushat e tjera të pjesëmarrjes. Kjo gjithashtu do të lejojë koordinimin e veprimeve të ndryshme mes institucioneve dhe profesionistëve.

Metoda

Hulumtimi Pjesëmarrës i Bazuar në Komunitet⁷ (Minkler and Wallerstein, 2003) është metodologjia e lokalizuar për të nxitur bashkëpunime midis anëtarëve të komunitetit dhe që ka krijuar:

- a) Formularin e raportimit nga shkolla dhe raportin e monitorimit;
- b) Profilin e funksionimit të fëmijës;
- c) Rekomandimet vepruese për shkollën dhe familjen.

Pyetjet hulumtuese

Ky raport i hulumtimit përshkruan procesin e ndërtimit të një dosjeje të dokumenteve duke filluar nga modeli i funksionimit bio-psiko-social, për të përfunduar me nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.

Qëllimi specifik i këtij studimi është nxitja e procesit të gjithëpërfshirjes në 7 komuna të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë) në të cilat janë ngritur grupe profesionale për monitorimin e përmirësimeve arsimore në arimin parashkollor dhe në shkollën fillore (të quajtura Ekipe Vlerësuese Komunale), me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të aftësive të institucioneve në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës. Duke u nisur nga këto premisa, pyetjet e hulumtimit që paraqesin një udhëzues në zhvillimin e procesit, ndahen në këtë mënyrë: a) Si mund të përhapen kulturat, politikat dhe praktikat gjithëpërfshirëse duke adaptuar modelin bio-psiko-social të funksionimit? b) Cilat dokumente, në përputhje me modelin dhe kornizën e KNF-së, mund të promovojnë më së miri rrugën drejt gjithëpërfshirjes në shkollë? c) Si mund të futen këto dokumente në përdorim nga komunat e Kosovës?

⁷ Community Based Participatory Research.

DIZAJNI I PILOT STUDIMIT

Ende në proces

Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 4	Faza 5	Faza 6	Faza 7
<p>Grupi punues</p> <p>Pjesëmarrësit: 17 persona: përfaqësuesit e Ekipeve Vlerësuese; përfaqësuesit e MASHT; përfaqësuesit e Save the Children; 2 hulumtues (Universiteti i Bolonjës dhe Universiteti i Padovës)</p>	<p>Ndërtimi i instrumenteve përmes hetimit narrativ (Bruner, 1991)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formulari i raportimit nga shkolla dhe raporti i monitorimit • Profili i funksionimit të fëmijës • Rekomandimet vepruese për shkollën dhe familjen <p>Pjesëmarrësit: të njëjtit si në fazën paraprake</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e të dhënave nga një komunë e Kosovës (Peja) • Draft instrumentet 	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi i mësimitdhënësve mbi draft instrumentet • Trajnimi i Ekipeve Vlerësuese mbi draft instrumentet 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e të dhënave përmes diskutimeve në fokus grupe me mësimitdhënës dhe anëtarë të Ekipeve Vlerësuese 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizimi i të dhënave mbi draft instrumentet 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpërndarja e instrumenteve (për të informuar, sensibilizuar, përfshirë) në komunat e Kosovës.



Tabela 1 – Fazat e realizimit të rrugës së hulumtim-trajnitimit.

Për të dëshmuar kompleksitetin e gjithë rrugëtimit, në paragrafët e mëposhtëm, të dy dimensionet (hulumtimi dhe trajnimi) dhe fazat që i kanë karakterizuar do të thellohen, por duke pranuar se ato janë të lidhura reciprokisht dhe nuk ndahen qartë.

3

Trajnimi

Aktiviteti huluntues është rezultat i një bashkëpunimi fillestar mes Departamentit të Shkencave të Edukimit të Universitetit të Bolonjës dhe Save the Children International, zyra në Kosovë, në kuadër të projektit “Promovimi i gjithëpërfshirjes në arsim dhe shoqëri i fëmijëve me nevoja të veçanta në 8 komuna të Kosovës”, që përmes mbështetjes teknike/shkencore, synojnë përkrahjen e një grupi pune ndërdisiplinor të ngritur dhe të udhëhequr nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), të interesuar për përcaktimin e metodave të përshtatshme të vlerësimit të rrugës së rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me Kornizën Ndërkombëtare të Klasifikimit të KNF-FR-së.

Seksioni i trajnimit/këshillimit ka përfshirë 17 pjesëmarrës (të paktën një përfaqësues të Ekipeve Vlerësuese të 7 komunave të Kosovës), Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, një përfaqësues të Save the Children dhe njohjen dhe përdorimin i KNF-FR-së.

Në fund të seksioneve trajnuese, pjesëmarrësit kanë organizuar vetë seksione trajnimi për të gjithë anëtarët e 7 Ekipeve Vlerësuese Komonale, asistentët socialë, mësimdhënësit e trajnuar për aktin e mbështetjes ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara, mjekët dhe përfaqësuesit e Drejtoritë Komonale të Arsimit, për të përmirësuar kompetencat mbi programin KNF-FR.

Përvoja e trajnimit bëri të mundur përcaktimin dhe zhvillimin, bazuar në nevojat e shprehura nga grupi ndërdisiplinor, një proces specifik kërkimor i mëtutjeshëm që synon bashkë-ndërtimin e një dosjeje të dokumenteve në përputhje me modelin KNF dhe të destinuara për ndërtimin e një profili vlerësimi nën kujdesin e komisioneve dhe i adresuar për t’u siguruar shkollave një skicë të udhëzimeve të dobishme për ndërtimin e Planit Individual të Arsimit.

Dokumentet iu nënshtruan një përdorimi të parë për të testuar funksionalitetin e tyre (maj-korrik 2018 në komunën e Pejës), përpara se të eksperimentohen dhe monitorohen, duke filluar nga viti shkollor, 2018/2019, në 7 komuna të Kosovës. Kjo ka lejuar arritjen në përkufizimin e përbashkët të një dosjeje të dokumenteve në përputhje me kontekstin në të cilin do të shpërndahen këto të fundit.

Eksperimentimi u parapri nga një program trajnimi për mësimdhënësit dhe anëtarët e ekipeve të vlerësimit, duke nisur nga gushti 2018.

Faza (4) e trajnimit të mësimeve

NR.	KOMUNA	SHKOLLA	MËSIMDHËNËSIT E TRAJNUAR MBI ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS NË TË KALUARËN (PO OSE JO)
1	Gjilan	Abaz Ajeti	Po
2	Gjilan	Zija Shemsiu	Jo
3	Ferizaj	Tefik Çanga	Po
4	Ferizaj	Jeta e re	Jo
5	Pejë	Ramiz Sadiku	Po
6	Pejë	Dardania	Jo
7	Gjakovë	Zekeria Rexha	Po
8	Gjakovë	Emin Duraku	Jo
9	Prishtinë	Asim Vokshi	Po
10	Prishtinë	Hilmi Rakovica	Jo
11	Mitrovicë	Migjeni	Po
12	Mitrovicë	Eqrem Çabej	Jo
13	Prizren	Ibrahim Fehmiu	Po
14	Prizren	Fadil Hisari	Jo

Tabela 2 - Faza e aftësimit të mësimeve

Siç shihet nga tabela, objektivi ka qenë të punohet me mësimeve që tashmë i ishin nënshtruar trajnimit për çështjet e arsimit gjithëpërfshirës përmes programit të Save the Children, por edhe të punohet me mësimeve që nuk i kishin përdorur këto resurse, për të favorizuar në këtë mënyrë një kontaminim gjenuin të vlerave dhe të parimeve gjithëpërfshirëse dhe për të kuptuar plotësisht vlerën e instrumenteve të identifikuara. Në të vërtetë, qëllimi ishte që të gjithë mësimeve, edhe ata pa kurrëfarë kompetence, apo me kompetencë minimale të KNF-së, të ishin në gjendje të plotësonin instrumentet.

Dosja përfundimtare përbëhet nga dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i raportimit nga shkolla dhe raporti i monitorimit*, që të dyja nën kujdesin e shkollës dhe për t'iu dërguar Ekipit Vlerësues Komunal;
- Profili e funksionimit të fëmijës*, i përpunuar nga Ekipet Vlerësuese Komunale. Qëllimi i këtij dokumenti është përmirësimi i profilit të funksionimit të secilit fëmijë, në lidhje me një kontekst që zvogëlon pengesat e të nxënës dhe të pjesëmarrjes dhe promovon aftësinë për zgjedhje të dobishme në ndërtimin e Planit Jetësor të një personi;
- Rekomandimet vepruese*, nën kujdesin e Ekipit Vlerësues Komunal që duhet t'i ofrojë shkollës dhe familjes sugjerime të dobishme për aktivizimin e veprimeve që synojnë promovimin e integritetit mes funksionimit efektiv të fëmijës dhe funksionimit të tij të mundshëm në kontekstin shkollor dhe familjar.



Trajnim për mësimeve rreth pilotimit të draft-instrumenteve për referencimin dhe vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vëzhgimit në të rriturë

30-31 gusht 2018
Hotel Albi, Prizren

Trajneri:
Prof. Roberto Dainese, Universiteti i Bolonjës
Prof. Elisabetta Ghedin, Universiteti i Padovës

AGJENDA

Data 1: 30 gusht 2018

9:00	Filimi i trajnimit
Paradite	Mirënjohje dhe prezantim i qëllimit të trajnimit. Pëna e parë: bazat pedagogjike mbi të cilat janë draftuar instrumentet.
Dreka	
Paradite	Pëna e dytë: dimensionet socio-pedagogjike të instrumenteve
16:30	Përfundimi i ditës 1

Data 2: 31 gusht 2018

9:00	Filimi i ditës 2
Paradite	Pëna e tretë: prezantimi i instrumenteve të draftuara
Dreka	
Paradite	Pëna e katërt: aktivitetet dhe detyrat e mësimeveve përgatitja fazës së

4

Puna hulumtuese

Një punë e tillë përqendrohet në Hulumtim Pjesëmarrës i Bazuar në Komunitet (anglisht: Community Based Participatory Research - CBPR) dhe nënkupton një qasje hulumtuese që thekson bashkëpunimet ndërmjet anëtarëve të komunitetit, organizatave, profesionistëve të fushës së shëndetit dhe hulumtuesve për të gjeneruar njohuri dhe për t'i zgjidhur problemet lokale (Doherty, Mendenhall, 2006; Izrael *et al*, 2005; Minkler, Wallerstein, 2003). Kjo metodologji përfshin qëllimisht dhe në mënyrë të drejtë hulumtuesit dhe anëtarët e komunitetit në të gjitha aspektet e procesit të hulumtimit, përfshirë procesin vendimmarrës, përforsimin e kapaciteteve, gjenerimin e njohurive dhe shpërndarjen e rezultateve.

Projektet e CBPR-së fillojnë duke përcaktuar një “grup punues”⁸ (anglisht: community of concern). Në itinerarin tonë të hulumtimit u përfshinë një grup pune ndërdisiplinor, siç është shkruar edhe më parë, si vijon: 2 përfaqësues të Ekipeve Vlerësuese për secilën komunë të Kosovës, 1 përfaqësues i MASHT-it, 1 përfaqësues i Save the Children, 2 hulumtues. Për më tepër, CBPR-ja është një proces ciklik dhe në evoluim të vazhdueshëm, me qëllim promovimin e një angazhimi të barabartë afatgjatë nga ana e hulumtuesve dhe e anëtarëve të komunitetit. Pikërisht për këtë arsye, “grupi punues” do të jetë aktiv gjatë të gjitha fazave të përcaktimit dhe zbatimit të të gjithë rrugës së trajnimit dhe hulumtimit.

Në fund të fundit, qëllimi i kësaj metodologjie hulumtimi është integrimi i njohurive të reja me përpjekjet për ndryshimin e komunitetit për përfitimin e ndërsjellë të të gjithë partnerëve të përfshirë në proces. Në këtë drejtim, CBPR-ja ofron zgjidhje praktike dhe të qëndrueshme, qëllimi kryesor i të cilave është përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së komuniteteve të përfshira (Riffin *et al*, 2016).

Literatura ka treguar një numër avantazhesh që mund të rrjedhin nga përdorimi i CBPR-së. Duke iu referuar rrugës së trajnimit/hulumtimit, këtu më poshtë do të analizohet secila prej tyre në detaje.

⁸ Sipas këtij parimi, çdo anëtar i komunitetit, edhe ai me më pak përvojë, gëzon të drejta të barabarta të përkatësisë, sepse një karakteristikë themelore e këtij komuniteti është diversiteti midis anëtarëve të ndryshëm të grupit. Pikërisht ky heterogjenitet i njohurive realizon dhe lejon shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizave. Aftësia njohëse, e kuptuar si një procedurë njohëse që lëviz nga praktika konkrete në abstraksion të koncepteve, vetive, procedurave të veprimit dhe strategjive të vetë-rregullimit që janë vendosur në nivelin njohës, na lejon të reflektojmë mbi praktikën e kujdesit, si diçka që ndërtohet në grup dhe që përfshin ndërgjegjësimin e një angazhimi të përbashkët për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, favorizimin e zgjidhjes bashkëpunuese të problemeve, të mësuarit si t'i zgjidhim ato duke punuar në grupe ose me një person më kompetent (Santi, 2006).

- I) *Të sigurohet që tema e hulumtimit të pasqyrojë një çështje themelore të identifikuar nga komuniteti. Kjo pikë i përgjigjet pyetjes se si të promovohet arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë në përputhje me deklaratat kryesore ndërkom-bëtare? Kjo është një pyetje e qartë dhe e negociuar gjatë fazave fillestare të kësaj rruge dhe përfaqëson një angazhim të marrë në mënyrë të qartë nga të gjithë anëtarët e grupit. Kuadri i funksionimit bio-psiko-social (KNF) ka përfaqësuar sfondin gjithëpërfshirës, pasi e plotëson mirë perspektivën e trefishtë të *Indeksit për Gjithëpërfshirje* (Booth, Ainscow, 2008; 2014):*
- a) të krijohet një kulturë gjithëpërfshirëse (fushë reflektimi mbi ndryshimin e perspektivës që sjell me vete adaptimin e modelit bio-psiko-social, duke iu referuar koncepteve të tilla si shëndeti, funksionimi, dhe mirëqenia);
 - b) të zhvillohen politika gjithëpërfshirëse (një dimension që përmirëson një vizion sistemik dhe që përfshin akterë të ndryshëm si Ministria, shërbimet, shkollat, familjet);
 - c) të prodhojë praktika gjithëpërfshirëse (vëmendja përqendrohet në projektin arsimor, me referencë të veçantë në dimensionet e KNF-së - faktorët kontekstualë - aktivitetin dhe pjesëmarrjen).
- II) *Të përmirësohet cilësia, vlefshmëria dhe ndjeshmëria e hulumtimit duke u bazuar në rrëfimin e përvojave të jetuara nga komuniteti. Në fillim të procesit, grupi ka identifikuar çështje të rëndësishme dhe vlerat kryesore për t'u hetuar, duke iu referuar pritshmërive të anëtarëve të komunitetit dhe të hulumtuesve, përmes një rruge të "hetimit narrativ" (anglisht: narrative inquiry) (Bruner, 1991), të krijuar dhe ndërtuar duke u mbështetur në historitë dhe përvojat e jetuara dhe duke bashkë-ndërtuar mbi këto domethënie të ndara mes studiuesve dhe pjesëmarrësve. Përse rrëfimi ndihmon për të kuptuar dhe për të vënë rend në një realitet që mund të duket edhe kaotik dhe, në këtë drejtim, rrëfimi është i barabartë me të treguarit e një historie, domethënë, për të bërë një ose më shumë njësi kuptimi të pajisura me një rend të brendshëm dhe zinxhirë mjaftueshëm të qartë, që do të na garantonin mirëkuptimin dhe shoqërimin e tyre me histori të tjera (Demetrio, 2012).*

- III) *Promovimi i besimit mes komunitetit dhe studiuesve.* Studiuesit kanë vepruar si një strukturë mbështetëse (*scaffolding*, (shqip: *skelë*) Bruner, 1997) me qëllim të inicimit, lehtësimit dhe promovimit të “dialogut” mes bashkëbiseduesve të ndryshëm. Mbështetje që gjatë takimeve është shpërndarë deri në arritjen e takimeve në të cilat u zhvillua “një proces i negociueshëm i transaksionit”, në të cilin vetë bashkëbiseduesit shkëmbyen dhe qarkulluan skriptat, skenarët, skemat e ngjashme konceptuale, por kulturalisht më të pasura se ato të zotëruara më parë prej tyre (Bruner, 1986).
- IV) *Të përmirësohet përkthimi i rezultateve të hulumtimit në politika dhe praktika.* Të gjithë pjesëmarrësit kanë punuar së bashku për të bashkë-krijuar njohuritë dhe për të bërë ndryshime në të gjitha aspektet e procesit të hulumtimit (Mendennhall, Doherty, 2005). Aspekti i përbashkët ishte bashkëpunimi i nënkuptuar si një marrëdhënie e mirëfilltë e pjesëmarrjes që mund të bëhet një model për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e kujdesit dhe që ka lejuar hartimin e dokumenteve në një perspektivë të KNF-së që konsiderohet e dobishme për fillimin e procesit të ndryshimit kulturor drejt gjithëpërfshirjes. Në këtë drejtim, dokumentet e krijuara mund të konsiderohen si “artefakte kulturore”, të cilat lejojnë që të përçohen jo vetëm praktika të ndryshme, por edhe kulturat dhe gjuhët e orientuara në përmirësimin e funksionimit të fëmijëve në raport me një kontekst që është ndërtuar si një lehtësues i Projektit të jetës.
- V) *Të përmirësohet përthithja e rezultateve të hulumtimit nga anëtarët e komunitetit.* “Grupi punues” u takua për të identifikuar një projekt pilot që u implementua në 14 shkolla të shtatë komunave të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë), për të cilin do të flitet në seksionin tjetër. Në fund, instrumentet e krijuara do të shpërndahen me qëllim që të ndërtohet një repertor i praktikave të mira që synojnë promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.

4.1 Pilot-projekti

Gjatë periudhës prill/qershor 2018 filloi faza e testimit (në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, u zgjodh komuna e Pejës dhe instrumentet u ndanë me 4 anëtarë të Ekipit Vlerësues Komunal, 4 mësimdhënës të një shkollë fillore dhe 3 edukatorë të një institucioni parashkollor publik).

Në qershor 2018, bazuar në vëzhgimet e marra nga personat e përfshirë në fazën e testimit, instrumentet u përshtatën dhe u arrit një version përfundimtar.

Nga shtatori 2018 instrumentet u përdorën në shtatë komuna të Kosovës; por nga një takim i parë në shkurt 2019 shkollat dhe Ekipet Vlerësuese Komunale i kanë përdorur instrumentet në mënyrë të dobët incizive: gjithsej, nga mësimdhënësit është plotësuar formulari i raportimit i vetëm 7 fëmijëve dhe vetëm 3 Ekipet Vlerësuese Komunale kanë punuar mbi profilin e funksionimit. Vetëm në Pejë është ndjekur i gjithë procesi, duke i kompletuar të gjitha instrumentet.

Këto janë raportet e pranuar në shkurt 2019:

- Instrumenti i ri, në krahasim me atë ekzistues, kërkon më shumë kohë dhe më shumë angazhim për t'u plotësuar.
- Instrumentet duhet të qartësohen më tej. Ka raste kur mësimdhënësit nuk janë të sigurt se në cilat aktivitete duhet të raportojnë çështje të caktuara brenda instrumentit.
- Mësimdhënësit dhe Ekipet Vlerësuese Komunale kanë nevojë për më shumë informacion mbi identifikimin e “Pengesave” dhe “Lehtësuesve” kur plotësojnë instrumentet. Në shumicën e rasteve, ata i konsiderojnë si të ndërvarura.

Në gusht 2019, filloi një mision për monitorimin në vend; takimi me mësimdhënësit që merreshin me përdorimin e instrumenteve ka lejuar përqendrimin në avantazhet që dolën gjatë kësaj periudhe të përdorimit të instrumenteve.

Mësimdhënësit e raportuan si të rëndësishme mundësinë e ofruar nga formulari i raportimit për të nxitur *bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes* dhe një ndarje që, në disa raste, e ka tejkaluar madhësinë e klasës individuale të cilës i përkiste fëmija i shënuar, për t'u zgjeruar në klasa të tjera, duke inkurajuar komunikimin dhe ndarjen e zgjidhjeve, mbi të cilat duhet të operohet. Për më tepër, formulari i raportimit ka lejuar *filtrimin e dërgimeve* në mënyrë më adekuate në Ekipet Vlerësuese Komunale. Në fund, mësimdhënësit kanë rënë dakord se për përdorimin e instrumenteve *një trajnim specifik përgatitor nuk është i nevojshëm*, pasi ato janë të lehta për t'u përpiluar.

Ndër pikat e dobëta, mësimdhënësit kanë renditur *mungesën e bashkëpunimit me drejtuesit e shkollave, zgjatjen e afatit kohor* që nga raportimi duhet të çojë në planin e ndërhyrjes dhe rrezikun që përpilimi i formularit të raportimit të ngatërrohet me një *veprim diagnostik*.

Takimi me anëtarët e Ekipit Vlerësues Komunal theksoi nevojën e dhënies së një mbështetjeje më të madhe institucionale këtij dimensionit të procesit të vlerësimit. Bëhet fjalë për çështjen e caktimit të kohës dhe instrumenteve për ta favorizuar punën e Ekipëve Vlerësuese Komunale, që ende duket se është shumë e kufizuar në disponueshmërinë e anëtarëve individualë të cilët do të kishin nevojë për një mbështetje më të përshtatshme dhe për njohje më të madhe nga institucionet. Ekipet duket se nuk janë të strukturuar të gjitha në mënyrë të barabartë dhe mbi-zotëron mungesa e pjesës mjekësore që do të lejonte përgatitjen e profileve më të përshtatshme, më adekuate dhe më të plota.

